

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.324/l.prot.

Peshkopi, më 19.04.2022

Lënda : Mbi verifikimin e ligjshmerise për vendimin e marrë

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.24, date 08.04.2022 "Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare", konstatova se :


1.Eshtë vepruar në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit të Brendshëm nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksin nr 1, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", pasi dokumentacioni përketes nuk është sipas standartit të kërkuar ,ndersa vleresimi i demit është kryer jo në përputhje me kërkesat e VKM nr.629, datë 15.05.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike".

2.Disa struktura të vleresimit në preventivin e banesës nuk përputhen me madhësinë e objektit.

3.Nga përmbajtja e vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi nuk del i pasqyruar fakti se produkti i dalë nga mbledhja e dates 08.04.2022 është rrjedhojë e një vendimi të rishqyrtuar sipas kërkeses së Prefektit, veprim që veç të tjerash bie ndesh me neni 34 të Rregullores Tip të miratuar me VKB nr.2, date 28.01.2020 që përcakton se "çdo çështje përpara se të shqyrtohet në mbledhjen e këshillit, duhet të shqyrtohet më parë nga Komisioni i Përhershëm....." .

Parë problemin në këndvështrim të arsytimit të mësipërm, të gjitha rrethanat e faktit të çojnë në përfundimin se një vendimmarrje e tillë është nxjerrë jo vetëm në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji, për të cilin shprehet neni 108 i ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH" por ka shkelje edhe të normave të legjislacionit material lidhur me mënyren e llogaritjes së vleres së demit.

Nisur sa sipër, vendimi nr.24, datë 08.04.2022 nuk mund të marrë miratimin e Prefektit në formën dhe përmbajtje e paraqitur pranë nesh.



324 14.04.22



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1176  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Peshkopi, më 14.04.2022

**Lënda:** Dërgim i Vendimeve për konfirmim

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

*Adresa: Bulevardi "Eles Isufi"*

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" po ju dërgojmë për konfirmim ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak Dibër më datë 08.04.2022

Bashkëngjitur do të gjeni vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 25 date 08/04/2022 " Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare per **Z.Miftar Murataj**.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**



Kapja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 25 Date 08/04/2022

**“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, neni 3, pika 9, neni 30, gërma gj, VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç,

**VENDOSI :**

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 1 kat** në pronësi të **z. Miftar Murataj** njësia administrative Sllovë ( fshati Zall - Kalis ) në shumën totale **3778065** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **3778065** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **ska**.
3. Nga fondi mbrojtjes civile të bashkisë Dibër i dëmtuari nuk është trajtuar pasi fatkeqësia natyrore ka ndodhur në vitin 2019. Janë ndjekur procedurat e vlerësimit të dëmit të shkaktuar në objekt deri në korrik 2021 dhe për këtë arsye dokumentacioni do i dërgohet AKMC pranë Ministrisë Mbrojtjes për trajtimin financiar në shumën prej **1889032** lekë ( 50 % të vlerës totale të dëmit )
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 25 Date 08/10/2022

**“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016 “ Për Prefektin e Qarkut “, Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019 “ Për Mbrojtjen Civile”, neni 3, pika 9, neni 30, gërma gj, VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012 “ Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” kreu III, pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç,

**VENDOSI :**

1. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 1 kat** në pronësi të **z. Miftar Murataj** njësia administrative Sllovë ( fshati Zall - Kalis ) në shumën totale **3778065** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **3778065** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **ska**.
3. Nga fondit mbrojtjes civile të bashkisë Dibër i dëmtuari nuk është trajtuar pasi fatkeqësia natyrore ka ndodhur në vitin 2019. Janë ndjekur procedurat e vlerësimit të dëmit të shkaktuar në objekt deri në korrik 2021 dhe për këtë arsye dokumentacioni do i dërgohet AKMC pranë Ministrisë Mbrojtjes për trajtimin financiar në shumën prej **1889032** lekë ( 50 % të vlerës totale të dëmit )
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1176  
Nr \_\_\_\_ Prot

Peshkopi, më 17.04.2022

**Lënda:** Dërgim i Vendimeve për konfirmim

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

*Adresa: Bulevardi "Eles Isufi"*

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" po ju dërgojmë për konfirmim ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak Dibër më datë 08.04.2022

Bashkëngjitur do të gjeni vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 25 date 08/04/2022 " Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare per **Z.Miftar Murataj**.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**  
  
